



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

**AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE LLOJET E
INVESTIMEVE TË LEJUARA TË KËTYRE AKTIVEVE**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 19, datë 28.04.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 106, datë 31.05.2019

Neni 1

Objekti

Objekti i rregullores është përcaktimi i llojeve dhe karakteristikave të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike të shoqërive të sigurimit/risigurimit, kategoritë e tjera të investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, përcaktimi i rregullave për diversifikimin dhe kufizimin në lidhje me investimin e këtyre aktiveve, si dhe rregullat për vlerësimin e këtyre aktiveve.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të pikës 5 dhe pikës 1, germa g), të nenit 97, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Politika e investimit

Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të mbajnë aktive në mbulim të provigjoneve teknike, jo më pak se vlera bruto e provigjoneve teknike.

Shoqëritë e sigurimit përcaktojnë në funksion të madhësisë së tyre, të natyrës dhe kompleksitetit të aktivitetit që kryejnë, politika investimi të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike në përputhje me profilin e riskut të detyrimeve të tyre, në mënyrë që të sigurojnë në vazhdimësi gjendjen e aktiveve të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e tyre.

Shoqëria e sigurimit, gjatë investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike merr parasysh afatin për përmbushjen e përgjegjësisë që rrjedhin nga kontratat e veçanta të sigurimit. Politikat e investimit përshtaten duke mbajtur parasysh që aktivet në mbulim të provigjoneve teknike kufizohen sipas parashikimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Kategori të tjera investimi të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike

1. Shoqëria e sigurimit përveç parashikimeve të nenit 97, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, lejohet të mbulojë provigjonet teknike, të ndryshme nga ato matematike dhe me aktivet e listuara më poshtë:
 - a. Hua të siguruara dhe hua të pasiguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë;
 - b. Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
 - c. Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;
 - d. Të arkëtueshmet nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;
 - e. Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike;
 - f. Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;
 - g. Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafitur;
 - h. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën “gj”, pika 1, e nenit 97, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - i. Interesa dhe qira të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara;
 - j. Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit Jeshil pranë BSHS;
 - k. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim.

2. Me miratimin paraparak të Autoritetit, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 97, të ligjit të mësipërm, aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, mund të investohen edhe në:
 - a. Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar i BE ose vend anëtar i OECD-së që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
 - b. Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar të BE ose vendi anëtar të OECD-së me kushtin që entitetet joqeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:
 - i. Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;
 - ii. Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.
 - c. Aksione të listuara të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar të BE ose vend anëtar të OECD-së;
 - d. Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të listuara, të cilat tregtohen në një vend anëtar të BE ose vend anëtar të OECD-së.
3. Nuk do të konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve teknike për shoqërinë e sigurimit:
 - a. Aktivet që shërbejnë për financimin e fondit të garancisë të një shoqërie sigurimi;
 - b. Investimet në pjesëmarrje si dhe letrat e tjera me vlerë të shoqërive të cilat janë filiale, shoqëri mbështetëse, aksionarë, në shoqërinë e sigurimit apo çdo rast tjetër që konsiderohet si palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit.

Neni 5

Diversifikimi dhe kufizimi i investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike

1. Shoqëritë e sigurimit përse i përket investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, mund të investojnë pa kufizim në:
 - a. Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë;
 - b. Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
 - c. Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;
 - d. Investimet në depozitat e garancisë së Kartanit Jeshil pranë BSHS-së, sipas kërkesës së BSHS-së.
 - e. Shumat që detyrohen nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit; Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor.

2. Shoqëritë e sigurimit përse i përket investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, mund të investojnë jo më shumë se:
- a. 10 përqind të provigjoneve teknike bruto në obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar apo të shoqëruara nga garanci të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germat c) dhe ç) të pikës 1 të nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - b. 35 përqind të provigjoneve teknike bruto në obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën d), pika 1 e nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - c. 5 përqind të provigjoneve teknike bruto në obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën dh), pika 1 e nenit 97 të Ligjit 52/14, me kusht që investimi i shoqërisë së sigurimit në një subjekt që emeton këto letra me vlerë nuk tejkalon 10 përqind të kapitalit të këtij të fundit;
 - d. 25 përqind të provigjoneve teknike bruto në aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën e), pika 1 e nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - e. 5 përqind të provigjoneve teknike bruto në aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën ë), pika 1 e nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - f. 40 përqind të provigjoneve teknike bruto në kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën f), pika 1, e nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - g. 10 përqind të provigjoneve teknike bruto për hua të siguruara dhe të pasiguruara në Republikën e Shqipërisë, vetëm me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë, sipas përcaktimeve në germën g), pika 1 e nenit 97 të Ligjit 52/14 dhe germës a), pika 1, e nenit 4 të kësaj rregulloreje, përfshirë 5 përqind të provigjoneve teknike neto për çdo hua të vetme;
 - h. 30 përqind të provigjoneve teknike bruto në Toka dhe Ndërtesa, përfshirë 10 përqind në çdo pjesë toke a ndërtesë ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra-tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht një investim, vetëm në rast se plotësohen kërkesat e përcaktuara në germën gj) të pikës 1 të nenit 97 të Ligjit 52/14;
 - i. Të marra së bashku, 15 përqind të provigjoneve teknike bruto në obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht sipas përcaktimeve në germën a), pika 3 e nenit 97 të Ligjit 52/14 dhe neni 4, pika 2/a e kësaj rregulloreje dhe në obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi

anëtar ose vendi anëtar të OECD-së, me kushtin që entitetet joqeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- i.1) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;
- i.2) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare, sipas përcaktimeve në germën b), pika 3 e nenit 97 të Ligjit 52/14 dhe neni 4, pika 2/b e kësaj rregulloreje;

j. 15 përqind të provigjoneve teknike bruto në investimet e marra së bashku sipas pikave j.1 dhe j.2 në vijim:

- j.1) Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së, sipas përcaktimeve në germën c), pika 3 e nenit 97 të Ligjit 52/14;
- j.2) Në kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së, sipas përcaktimeve në germën ç), pika 3 e nenit 97 të Ligjit 52/14.

- k. 1 përqind në kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1/b e kësaj rregulloreje;
- l. 3 përqind të provigjoneve teknike bruto në formën e parasë dhe ekuivalentëve të saj, sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 1/c e kësaj rregulloreje;
- m. 25 përqind e vlerës së provigjoneve teknike për llogaritë e arkëtueshme nga risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike, në përputhje dhe me germat d) dhe e), pika 1, e nenit 4 të kësaj rregulloreje;
- n. 20 përqind të provigjoneve teknike bruto në depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato, sipas përcaktimeve në germën f), pika 1, të nenit 4, të kësaj rregulloreje;
- o. 5 përqind të provigjoneve teknike bruto në aktive të qëndrueshme të trupëzuara, të ndryshme nga tokat dhe ndërtesat, sipas përcaktimeve në germën h), pikën ,1 neni 4, i kësaj rregulloreje;
- p. 5 përqind të provigjoneve teknike bruto në interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara, sipas përcaktimeve në germën i), neni 4 i kësaj rregulloreje;
- q. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim sipas përcaktimeve në germën k), neni 4 i kësaj rregulloreje, por jo më shumë se 15 % e provigjonit të primit të pafiturar.

Neni 6
Vlerësimi i aktiveve

Aktivet në mbulim të provigjoneve teknike të cilat investohen në përputhje me kërkesat e nenit 97, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, duhet të vlerësohen në përputhje me “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.